



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kutbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: 17.06.2025 VI-020-343
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe të Kryetarit Leonora Bajrami, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Pejës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.20/2025 mbi miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private me qëllim: "Të ndërtimit të objektit të ri të administratës komunale dhe formimin e rrugës tek ura e re" si interes publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

I miratuar më datë: 29.05.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025, ka miratuar Vendimin Nr.20/2025 mbi miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private me qëllim: "Të ndërtimit të objektit të ri të administratës komunale dhe formimin e rrugës tek ura e re" si interes publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës është bazuar me nenin 11,12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 24 dhe 25 të Ligjit Nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi Nr.20/2025 mbi miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private me qëllim: "Të ndërtimit të objektit të ri të administratës komunale dhe formimin e rrugës tek ura e re" si interes publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal është miratuar në mbledhjen e Kuvendit me datë 29.05.2025, me 16 vota për, 8 kundër dhe 1 abstenim.

Neni 14 paragrafi 14.2 e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale sqaron se: Komunitet kanë të drejtë të shesin dhe japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

Bazuar në dispozitën e lartshënuar në rastet kur prona e komunës është vlerësuar me çmim më të lartë nga Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, personi fizik apo juridik diferencën nuk mund të e kompensoj me mjete financiare.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Gazmend Muhaxheri, gradonačelnik opštine Peć Rexhep Kutbogaj, predsedavajući Skupštine opštine Peć		
Cc::	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini		
Preko:	PER	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,	Data, 17.06.2025 VI-020-343
Od:		Erblin Hetemi, rukovodilac Pravnog odeljenja / MALS	
Odgovorni službenici:			
1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za razmatranje zakonitosti akata opštine i gradonačelnika		
2.Službenik/ca za izradu pravne ocene	Leonora Bajrami, viša službenica za razmatranje zakonitosti akata opštine		
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Peć		
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Peć		

Poštovani/a gradonačelniče/c,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 20/2025 o odobrenju razmene nepokretne imovine opštine privatnom svojinom u svrhu: „Izgradnje nove zgrade opštinske uprave i formiranja puta do novog mosta“ kao javni interes, prema Planu razvoja opštine
Usvojena dana, 29.05.2025.god
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 02.06.2025.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Peć je na sednici održanoj dana, 29.05.2025.godine, odobrila Odluku br. 20/2025 o odobrenju razmene nepokretne imovine opštine privatnom svojinom u svrhu: „Izgradnje nove zgrade opštinske uprave i formiranja puta do novog mosta“ kao javni interes, prema Planu razvoja opštine, donetu od strane Skupštine opštine Peć.

MALS konstatuje da je doneta odluka od strane Skupština opštine Peć, zasnovana na članu 11, 12 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 24 i 25 Zakona br. 06/L-092 o davanju i razmeni nepokretne imovine opštine, članu 29 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura davanja na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine.

Odluka br. 20/2025 o odobrenju razmene nepokretne imovine opštine privatnom svojinom u svrhu: „Izgradnje nove zgrade opštinske uprave i formiranja puta do novog mosta“ kao javni interes, prema Planu razvoja opštine, usvojena je na sednici Skupštine opštine dana, 29.05.2025. godine, sa 16 glasova za, 8 protiv i 1 uzdržan.

Član 14. stav 14.2. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi pojašnjava da: Opštine imaju pravo da prodaju i izdaju u zakup pokretnu i nepokretnu imovinu u skladu sa zakonom, sa izuzetkom prodaje zemljišta koja je regulisana posebnim zakonom.

Na osnovu gore navedene odredbe, u slučajevima kada je opštinska imovina procenjena po višoj ceni od strane Odseka za procenu nepokretnosti za eksproprijaciju i razmenu pri Ministarstvu finansija, rada i transfera, fizičko ili pravno lice ne može nadoknaditi razliku finansijskim sredstvima.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJES MUNICIPALITY OF PEJA

Dokumenti i Administratës së Detyrës Dokument i Detyrës së Administratës së Detyrës	
Data: 09.06.2025	
-V- 020-343	

KUVENDI I KOMUNES SË PEJES

L.Numër: 400/01-29890, dt: 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shtator 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nën titullin 20 paragrafi 1 pika 1/1 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës L.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financë, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 20/2025

Mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Ndërtimit të Objektivit të Ri të Administratës Komunale dhe Formimit të Rrugës tek Ura e Re" si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të ndërtimit të objektivit të ri të Administratës Komunale dhe formimit të rrugës tek ura e re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë pronë e pronarit Arton (Sali) Kelmendi dhe ngastra nr.2729-0 në sipërfaqe 289m² ZK Pejë me shtëpi, pronë e bashkëpronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, do të merren me qëllim të ndërtimit të objektivit të ri të Administratës Komunale dhe formimit të Rrugës tek Ura e Re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me 1/2 e ngastrës kadastrale nr.5755-118 e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 7641m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Puntës dhe Transfereve - Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme të aprovuara me datën 29.05.2025.

- Prona e Komunës së Pejës, ngastra kadastrale nr.5755-118 në sipërfaqe prej 7641m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² apo totali 611,280.00 €, e që i bie së 1/2 e kësaj ngastrë është vlerësuar me gjithsej 305,640.00 €.

- Prona private e pronarit Arton (Sali) Kelmendi, ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë është vlerësuar me 110.00 €/m² që në total i bie 29,920.00 €.

- ngastra në pronësi të Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi me nr.2729/0 në sipërfaqe prej 289m² ZK Pojë me shtëpi është vlerësuar me 600.00 €/m², ndërsa vlera e investimeve është vlerësuar me 112,200.00 €, që në total bie 285,600.00 €.

Pra, të dyja këto ngastra në pronësi private të Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi së bashku me investimet janë vlerësuar në total 315,520.00 €.

- Andaj obligohet Komuna e Pejës që të paguajë diferencën në shumën prej 9,880.00 € Arton (Sali) Kelmendit dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendit bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimin të Ligjshmerisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi t'i dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ-së
Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJES MUNICIPALITY OF PEJA

OPŠTINA PEÇ

Stamp and administrative markings on the right side of the document, including a date stamp "02.06.2025" and a handwritten number "020-543".

SKUPŠTINA OPŠTINE PEÇ

I.Br: 400/01-29890, dana 29. Maja 2025

Na osnovu člana 11 i 12 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br. 03/L, 10 od dana 20. Februara 2003, i na osnovu članova 24 i 25 Zakona br.06/L-092 o Davanju na Koršćenje i Razmeni Opštinske Imovine, člana 29 Pravilnika VRK o određivanju postupka davanja na korišćenje i razmeni opštinskih nekretnosti, kao i člana 20 stav 1 tačka 1.4 Statuta br.01/2020 Opštine Peç, I. Br: 01-0 001-413431 od 30. septembra 2020, posle razmatranja predloga Gradonačelnika Opštine za usvajanje razmene opštinskih nekretnosti za nekretnine privatnih suvlasnika Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzani (Sejfedin) Kelmendi, po preporuci Komiteta za Politiku i Finansije, Skupština Opštine Peç je na sednici održanoj dana 29. maja 2025, donela ovu:

ODLUKU

br. 20/2025

O usvajanju razmene opštinskih nekretnosti za privatnu imovinu sa ciljem izgradnje novog objekta opštinske administracije i formiranje puta kod novog mosta, u javnom interesu, prema Opštinskom razvojnem planu

- I. Usvaja se predlog Gradonačelnika Opštine za razmenu opštinskih nekretnosti za privatnu imovinu sa ciljem izgradnje novog objekta opštinske administracije i formiranje puta kod novog mosta, u javnom interesu, prema Opštinskom razvojnem planu.
- II. Katastarska parcela broj 5502-3, površine 272 m², KZ Peç, vlasništvo vlasnika Arton (Sali) Kelmendi, kao i parcela broj 2729-0, površine 289 m², KZ Peç - sa kućom, u zajedničkom vlasništvu Arton (Sali) Kelmendi i Egzani (Sejfedin) Kelmendi, biće preuzete u svrhu izgradnje novog objekta Opštinske administracije i formiranja puta kod novog mosta, kao javni interes, u skladu sa Opštinskim razvojnim planom. Istovremeno, navedene parcele će biti predmet razmene sa katastarskom parcelom broj 5755-118, površine 7641 m², KZ Peç, u vlasništvu Opštine Peç.
- III. Sastavni deo ove odluke je procena od strane Ministarstva Finansija, Rada i transfera-Odeljenje Poreza na Imovinu, usvojena dana 29.05.2025.

- Nekretnina u vlasništvu Opštine Peç, katastarska parcela broj 5755-118 površine 7641 m², KZ Peç, procenjena je na 80,00 €/m², odnosno ukupno 611.280,00 €, što znači da je ½ ove parcele procenjena na ukupno 305.640,00 €.

- Privatna nekretnost u vlasništvu Arton (Sali) Kelmendi, katastarska parcela broj 5502-3 površine 272 m², KZ Peç, procenjena je na 110,00 €/m², što ukupno iznosi 29.920,00 €.

- Katastarska parcela broj 2729-0 površine 289 m², KZ Peç, u vlasništvu Arton (Sali) Kelmendi i Egzani (Sejfedin) Kelmendi, sa kućom, procenjena je na 600,00 €/m², dok je vrednost investicija procenjena na 172.200,00 €, što ukupno iznosi 285.600,00 €.

Dakle, obe parcele u privatnom vlasništvu Arton (Salij) Kelmendi i Hgzana (Sejfedin) Kelmendi, zajedno sa investicijama, su procenjene na ukupno 315.520,00 €.

- Stoga se Opština Peč obavezuje da isplati razliku u iznosu od 9.880,00 € Artonu (Salij) Kelmendiju i Hgzanu (Sejfedin) Kelmendi, na osnovu Procene izvršene od strane Ministarstva finansija, rada i transfera Odeljenja za procenu nepokretne imovine.

- IV. Ovaj postupak razmerno podleže proceni zakonitosti od strane Ministarstva za Administraciju Lokalne Vlasti.
- V. Za primenu ove odluke zadužen je Gradonačelnik Opštine i Direktorat za Pravno-Imovinska Pitanja.
- VI. Ova odluka biće objavljena 30. dana posle registrovanja u Kancelariji za Protokolisanje u MALV-u, i stupa na snagu 7 dana posle objavljivanja na službenim jezicima na web stranici Opštine Peč.

Odluka se dostavlja:

- 1x1 MALV-u,
- 1x1 Gradonačelniku Opštine,
- 1x1 DPJP-u,
- 1x1 Arhivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

<i>Data/Nr.</i>	<i>02.05.2025 Nr. 15-463-ZRL-74/2025</i>
<i>Për:</i>	<i>Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit Komunal të Pejës</i>
<i>CC:</i>	<i>-Të gjithë anëtarëve të Kuvendit Komunal të Pejës -Komitetit për Politikë dhe Financa -Drejtorisë për Çështje Pronësore -Juridike -Arkivit</i>
<i>Nga:</i>	<i>Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës</i>
<i>Lënda:</i>	<i>Propozim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, ndërtimit të objektit të ri të Administratës Komunale, përkatësisht formimin e rrugës tek ura e re në këto ngastira, si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.</i>

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi I pika 1,4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I. Numër: 01-016/01-413431 të datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës i propozon për Miratimin dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e paluajtshme të bashkëpronarëve privat Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, Kuvendit Komunal Pejë, këtë:

PROPOZIM

Mbi Miratimin e Propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim: "Të ndërtimit të objektit të ri të Administratës Komunale si dhe formimin e Rrugës tek Ura e re" si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.

Këmbimi do të bëhet në mes të Komunës së Pejës dhe pronës private të bashkëpronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, objekt këmbimi do të jetë $\frac{1}{2}$ e ngastrës kadastrale nr.5755-118 në sipërfaqe prej 7641m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës, kjo ngastër do të këmbëhet me pronën private të bashkëpronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi me numër të ngastrës 2729-0 në sipërfaqe prej 289 m² ZK Pejë me shtëpi, si dhe ngastrën kadastrale me numër 5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë në pronësi të Arton (Sali) Kelmendi, të cilat ngastira do të merren me qëllim të ndërtimit të objektit të ri të Administratës Komunale si dhe Formimin e Rrugës tek Ura e re si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.

Këto prona janë dërguar për Vlerësim në Departamentin për Vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në Prishtinë.

Kjo procedurë do të nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Pjesë përbërëse e këtij propozim Vendimi janë:

- Certifikatat e pronësisë
- Kopjet e planit
- Materialet përcjellëse

Me respekt!



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: _____

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I. Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: _____ 2025, mori këtë:

PROPOZIM VENDIM

Nr. ____/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Ndërtimit të Objektit të Ri të Administratës Komunale dhe Formimin e Rrugës tek Ura e Re", si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të ndërtimit të objektit të ri të Administratës Komunale dhe formimit të rrugës tek ura e re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë pronë e pronarit Arton (Sali) Kelmendi dhe ngastra nr.2729-0 në sipërfaqe 289m² ZK Pejë me shtëpi, pronë e bashkëpronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, do të merren me qëllim të ndërtimit të objektit të ri të Administratës Komunale dhe formimin e Rrugës tek Ura e Re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me ½ e ngastrës kadastrale nr.5755-118 e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 7641m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme të aprovuara me datën 29.05.2025.

- Prona e Komunës së Pejës, ngastra kadastrale nr.5755-118 në sipërfaqe prej 7641m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² apo totali 611,280.00 €, e që i bie se ½ e kësaj ngastre është vlerësuar me gjithsej 305,640.00 €.

- Prona private e pronarit Arton (Sali) Kelmendi, ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë është vlerësuar me 110.00 €/m² që në total i bie 29,920.00 €.

- ngastra në pronësi të Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi me nr.2729-0 në sipërfaqe prej 289m² ZK Pejë me shtëpi është vlerësuar me 600.00 €/m², ndërsa vlera e investimeve është vlerësuar me 112,200.00 €, që në total i bie 285,600.00 €.

Pra, të dyja këto ngastra në pronësi private të Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi së bashku me investimet janë vlerësuar në total 315,520.00 €.

- Andaj obligohet Komuna e Pejës që të paguajë diferencën në shumën prej 9,880.00 € Arton (Sali) Kelmendit dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendit bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Lajshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-juridike.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

KRYESUESI I KUVENDIT

REXHIEP KURIBOGAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEČ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT
DEPARTMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE

PËR/ZA/TO:	Arianit Krasniqi – Drejtor për Çështje Pronësoro-Juridike
NGA/OD/FROM:	Mirjeta Gj. Rizvanolli – Arkitekte njësi për planifikim urban, DUMM – K. K. Pejë
CC:	Arta Nallbani – Drejtoreshë e DUMM
REFERENCE:	08-350-15245
DATË/A:	03.03.2025
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Pergjigje në kërkesë

I nderuar

Në kërkesën e Juaj me nr.08-350-15245 të datës 03.03.2025 kërkon informacion se çka parashitet me Planin Zhvillimor Komunal dhe Harten Zonale Komunale 2023 - 2031 në ngastrën kadastrale nr.2729-0 në Z.K. Pejë, në K.K.Pejë Ju njoftojmë se:

- Ngasatra kadastrale e cekur më lartë është pjesë e Hartës Zonale Komunale 2023 – 2031 të miratuar me vendimin nr. 65/2023, datë 28.12.2023 Bazuar në shfrytëzimin e tokës sipas Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale 2023 – 2031 ngastrata kadastrale nr. 2729-0 në Z.K. Pejë, K.K.Pejë me destinim: Zonë shërbim komuniteti – Shërbim i administratës publike – Objekt Komunal Administrat.

Ju faliminderit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEÇ
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE Mbrojtje të mjedisit
DEPARTMENT FOR URBANISM AND ENVIRONMENT PROTECTION
ODELENJE ZA URBANIZAM I ZAŠTITU ŽIVOTNE SREDINE

PËR/ZA/TO:	Arianit Krasniqi – Drejtor për Çështje Pronësoro-Juridike
NGA/OD/FROM:	Hana Muhaxheri – Arkitekte njësjë për planifikim urban, DUMM – K. K. Pejë
CC:	Arta Nallbani – Drejtoreshë e DUMM
REFERENCE:	08-350-15235
DATË/A:	03.03.2025
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Pergjigje në kërkesë

I nderuar

Në kërkesën e Juaj me nr.08-350-15235 të datës 03.03.2025 kërkon informacion se çka parashifet me Planin Zhvillimor Komunal dhe Harten Zonale Komunale 2023 - 2031 në ngastrën kadastrale nr.5503-9, 5502-3 në Z.K. Pejë, në K.K.Pejë Ju njoftojmë se:

- Ngasatra kadastrale e cekur më lartë është pjesë e Hartës Zonale Komunale 2023 – 2031 të miratuar me vendimin nr. 65/2023, datë 28.12.2023 Bazuar në shfrytëzimin e tokës sipas Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale Komunale 2023 – 2031 ngastrat kadastrale nr. 5503-9, 5502-3 në Z.K. Pejë, K.K.Pejë me destinim: një pjesë infrastrukturë – rrugë tek ura e re dhe pjesa tjetër zonë banimi.

Ju faliminderit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department
Komuna: Pejë Zona Kadastrale: Pejë

Të dhënat sipas Etabliment/Certifikates së Pronës					Vlerësimi	
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/Klasa e kualitetit	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Totali (€)
1	Komuna e Pejës	5755-118	Infrastruktura/Rrugë	7641	7641	611,280.00
Total						

4/2



Approvuar: 29.05.2025

305 640

Burehu

- 345,520



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

Komuna: Pejë Zana Kadashtare: Pejë

Nr.	Të dhënat sipas Elabrorit/Certifikates së Pronës				Vlerësimi		
	Prunat/Poseduesi	Numeri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/Klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Çmimi i tokës (€ / m ²)	Vlera e Investimeve €
1	Artan (Sali) Kelemenj	5502-3	Infrastrukturë/Rrugë	272	272		110.00
2	Artan (Sali) Kelemenj; Egzera (Sejdi) Kelemenj	2729-0	Tokë ndërtimore/Oborr/Shëtit	289	289	112.200.00	600.00
Total							315,520.00

APRIL 1 23.05.2025

[Signature]



01/ 9880.

Kom. → Pejë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY



CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611071-05755-118

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 030197/25
Data dhe koha e kështimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 06.05.2025 - 14:29
Komuna / Opština / Municipality: PEJE / PEČ / PEJE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone: PEJE / PEČ / PEJE
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: PEJE / PEČ / PEJE

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj kadastrske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS L/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrimi Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71611071-05755-118	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shtetërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Uthun	7641	R.799/2019/L.461/2024 R.1238/2024R.11/2025 R.229/2025	03.01.2025	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postel Poštanski kod Postal Code	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GRADINE		03.01.2025	



A.2.11.001 ISHPRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Blloq / Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës / Vrstja koriscenja parcelë / Parcel Type Of Use	Shtfrytëzimi aktual i parcelës / Vrstja koriscenja parcelë / Parcel Current Use	Kualiteti i krahës / Kvaliteti krahë / Quality Class	7641
	Infrastruktura/Infrastrukturë/Infrastructure	Rrugë/Durrëad		

B. PRONARI/POSEDESI - VLASNIK/DRËALAC - OWNER/POSSESSOR

Idetifikuesi i drejtësi / Prava / Rights	Emri i emri / Name	Nr. personi / Licent ID. No.	Vendbanimi / Prebivalite / Resident	Kodi postor / Posturi ID. No.	Emri i adresës / Pjesëtimet / Address details	Pjesa e pronës / Detyrues / Share quality	Përshkrimi / Opis / Description	Aktualizuar / Aktualizuar / Updated
Identifikuesi i drejtësi / Prava / Rights	Komuna e Pejës	600346466	PEJË / PUÇ / PEJE /		ALEKSANDER MOISIU	1/1	Bartje e posedimit sipas aktit juridik - Aktvendim Nr. 15-463/V.RI - 23/24 dt 29.05.2024 lëshuar nga DCPJ-Peje R. 12/8/2024	28.02.2025




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pejë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71611071-05755-118	Parcelë / Parcela / Parcel	7641



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1162

Punoi/Obrađio/Created: Qerim Morina
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 07.05.2025
Kohë/ Vreme/ Time: 11:12:18



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Života i Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY



CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611071-02729-0

Numbri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	030197/25
Data dhe koha e ngritjes / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:	06.05.2025 - 14:31
Komuna / Opština / Municipality:	PEJE / PEĆ / PEJE
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Pejë / Pec / Pejë
Zyra kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office:	PEJE / PEĆ / PEJE

A.1.1 DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA							
Numbri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cat. Unit No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona URS G/S URS	Superfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijtar më data Urađeno na dan Created On	Akturuar Aktualizano Updated
P-71611071-02729-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatno imovina / Privately owned Land		289			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qendrës Mesto avano Calle place	Kodi Postel Postanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijetar më data Urađeno na dan Created On	Akturuar Aktualizano Updated
UL.39 NOVEMBAR				



A.2.1.1. LOJI I SHIRYËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i lojit / Parcel Number	Loji i shirytëzimit të parcelës / Vryta korisçenja e parcelës / Parcel Type Of Use	Shtyrëzimi aktual i parcelës / Tërminjo korisçenja e parcelës / Parcel Current Use	Kundëri i klasës / Kvaliteti i klasës / Quality Class
	Tokë Ndërtimore/Craçje/vrsta e zemrës/Construction land	Obor/Dyrtë/Back Yard	209
	Tokë Ndërtimore/Craçje/vrsta e zemrës/Construction land	Shtëpi-Ndërtim/Kurrë Zgjidhje/House-Building	38



B. PROVARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRËZALAC - OWNER/POSSESSOR

Titulli i drejtësi / Prava / Rights	Emri i emrit / Name	Nr. i personit / Licent broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebysiliste / Resident	Kodi postar / Postanski kod / Postal code	Hollësi i adresës / Pjesëdhënës i adresës / Address details	Pjesa e pronës / Udhëdhënës / Share quota	Përshkrimi / Opis / Description	Azhuruar / Aktualizim / Updated
Provar / Përshkrim / Zgjidhje e posedimit / Parcel Possession	Kelmendi Artur (Saif)	1009006717	PEJE / PEC / PEJE /		Isa Demaj	/	R.121/2025	06.02.2025
Provar / Përshkrim / Zgjidhje e posedimit / Parcel Possession	Kelmendi Egzona (Selfedia)	1009006709	PEJE / PEC / PEJE /		Rr. Qazmend Zolpu.Nr.34	/	R.121/2025	06.02.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pejë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71611071-02729-0	Parcelë / Parcela / Parcel	289



Shkalla/Razmera/Scale: 1:100

Punoi/Obradilo/Created: Gerim Morina

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënimi/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 07.05.2025

Koha/ Vreme/ Time: 11:11:33



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71611071-05502-3

Numeri i Jëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 030197/25
Data dhe Koha e Iëshimit / Datum i Vreme Izdavanja / Date and time of submission: 06.05.2025 - 14:31
Komuna / Opština / Municipality: PEJE / PEC / PEJE
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pejë / Pec / Pejë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: PEJE / PEC / PEJE

A TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Nazimi i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijetar më data Urađeno na dan Created On	Azhuruar data Ažurirano Updated
P-71611071-05502-3	PARCELE / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	272	Ketësia nr.01-5-1/269 dt.14.09.2006 R.229/2025	03.01.2025	

A/1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qendrës Mesto zvanio Called place	Kodi Postali Poštanski kod Postal Code	Krijetar më data Urađeno na dan Created On	Azhuruar data Ažurirano Updated
GRADINA		03.01.2025	



A2.1.1. LOJI I SHIRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Hesq Number	Lloji i shirytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shirytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i Masës Kualiteti i Masës Quality Class	Kontrollimi i Kontrollimi i Control
	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë/PatRoad		272



B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Tipi i drejtimit Prava Rights	Emri i Imer Name	Nr. personal Liqid broj ID. No.	Vendbanimi Prethvaliste Residenti	Kodi postar Postanski kod Postal code	Identifikimi i adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Aktuarial Abitirano Updated
Udhëtarë dhe/ose / Pos Zemalac/dobroputenje /	Kelmendi Arton (Sali)	1009906717	PRITE / PRIC / PRIB /		Isa Derno	1/1	R.2/2022	28.02.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PEJË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pejë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71611071-05502-3	Parcelë / Parcela / Parcel	272





Shkalla/Razmera/Scale: 1:320

Punci/Obradio/Created: Qerim Morina
Nënshkrimi/Polpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 07.05.2025
Koha/ Vreme/ Time: 11:10:53









Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

DATE/A:	29.5.2025
REFERENC-Ë:	73/2025
PËR/ZA/TO:	Gazmend MUHAXHERI, Kryetar i Komunës - Pejë Arianit KRASNIQI, Drejtor i Drejtoratit për Çështje Pronësoro-Juridike
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
CC:	Artan AHMETI, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Lindita TOÇI, U.D Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme Florije ZABËRGJA, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzim i Raportit të Vlerësimit - Kërkesë për vlerësim referencë: 15-463/-LRL-74/2025 datë 04.03.2025-Komuna Pejë

Te nderuar,

Në vijim të kërkesës së bërë nga Komuna e Pejës, me subjekt: Kërkesë për vlerësim referencë: 15-463/-LRL-74/2025 datë 04.03.2025, (Pranuar në MFPT Nr 73/2025 prot, Datë 10.03.2025), në zbatim të ligjit Nr. 03/L-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit NR. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës", Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ka finalizuar procedurën për vlerësim sipas kërkesës.

Për vlerësimin e pronave të paluajtshme, stafi i DVPP-së, filluan punën për inspektimin e pronave, përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për të dhënat e tregut në zonën përreth pronave, të cilat vlerësohen me qëllim Këmbimi.

Gjatë inspektimit u kryen verifikimet për pronat që do të vlerësohen, u përcaktua vendndodhja e pronës, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Raportet e Vlerësimit janë hartuar bazuar në:

- Ligjin Nr. 03/L-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij

- Udhëzimi Administrativ MF - Nr. 02/2015 Për Miratimin e Metodave dhe Kriterëve Teknikë të Vlerësimit për Përlogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe Dëmeve që kanë të Bëjnë me Shpronësimin;

-Ligjin NR. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës";

- Rregullore (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju përcjellim:

- a.) Të dhënat e pronave dhe pronareve (sipërfaqja totale, sipërfaqja që vlerësohet dhe shuma për kompensim), në formë tabelare 2 kopje fizike .
- b.)Përshkrimin e metodologjisë së përdorur për kryerjen e vlerësimit;
- c.) Vlerën e përgjithshme të pronës e cila është objekt i vlerësimit së bashku me një përshkrim të komponentëve përbërës të vlerës (Raporti i Vlerësimit 2 kopje)

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department
Komuna: Pejë Zona Kadastrale: Pejë

Komuna e Pejës Zona rrethorë nr. 1						Vlerësimi	
Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikates se Pronës							
Nr.	Pronar/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/klasa e kualitetit	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Cmimi i tokës (€ / m ²)	Totali (€)
	Komuna e Pejës	5755-118	Infrastruktura/Rrugë	7641	7641	80.00	611,280.00
1	Total						

Athor: M. R. 29.05.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme - Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department
Komuna: Pejë Zona Kadastrale: Pejë

Të dhënat sipas Elaboratit/Certifikatës së Pronës					Vlerësimi	
Nr.	Pronat/Poseduesi	Numri i pronës	Lloji i shfrytëzimit të pronës/dasa e kualiteti	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për vlerësim m ²	Totali (€)
1	Komuna e Pejës	5755-118	Infrastrukturë/Rrugë	7641	7641	611,280.00
Total						

APPROVED: 29.05.2025

JA





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme

Odeljenje za Procenu Nepokretnosti- Immovable Property Appraisal Department

RAPORT – VLERËSIMI

Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim

HYRJA

Më datë 14.03.2025 mbështetje të nenit 22, paragrafi 3 i ligjit Nr. 03/L-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës" dhe Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim, mori në shqyrtim kërkesën referencë: 15-463/-LRL-74-2025 datë 04.03.2025, (Pranuar në MFPT Nr 73/2025 prot, Datë 10.03.2025), që i përket subjektit:

Organi Shpronësues : Komuna Pejë

Me objekt kërkesë : Kërkesë për vlerësim referencë: 15-463/-LRL-74-2025 datë 04.03.2025-Komuna Pejë

PËRMBAJTJA

Prona: 5502-3

Pronar : Arton (Sali) Kelmendi

Zona Kadastrale: Pejë

Komuna: Pejë

Data e inspektimit : 30.04.2025

Data e Vlerësimit: 29.05.2025

Përgatiti raportin: DIVIZIONI PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË
PALUAJTSHME PËR SHPRONËSIM DHE KËMBIM

Vlera e pronës së paluajtshme: 29,920.00 EURO



I. LIGJET E APLIKUESHME

Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbimi në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë përmes ligjit.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/L-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, si dhe akti nënligjor i cili derivon nga Ligji Udhëzimin Administrativ nr 02/2015 të miratuar nga Ministria e Financave "Për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

Po ashtu me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes", Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme i është shtuar edhe përgjegjësia e vlerësimit të pronave të paluajtshme të cilat janë objekt Këmbimi i pronës komunale me persona fizik dhe juridik.

Dhe akti nënligjor i cili derivon nga Ligji- Rregullorë (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes.

Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij raporti, termat dhe shprehjet, kurdo që përdoren në këtë raport, kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht kanë kuptim tjetër:

"Pronë e Paluajtshme" nënkupton

- (i) tokën,
- (ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuara në, mbi ose nënsipërfaqen e tokës si dhe
- (iii) pjesët përbërëse dhe sendet aksesore të cilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përthshme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe
- (iv) frutat e pa shkëputura nga toka."

" Pronë e paluajtshme e Komunes" – pronë e paluajtshme e regjistruar në emër të komunës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

" Këmbimi" - e drejta e Komunes për të bërë ndërrimin e pronës së paluajtshme të Komunes me personat fizik dhe juridik.

II. TË DHËNAT MBI PRONËN SIPAS ÇERTIFIKATËS MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME:

Pronari:	Arton (Sali) Kelmendi
Adresa:	
Zona kadastrale:	Pejë
Nr. i pronës:	5502-3
Komuna:	Pejë
Kultura/ Klasa:	Infrastrukturë/Rrugë
Sipërfaqja e përgjithshme:	272 m ²

QËLLIMI I VLERËSIMIT

Shpronësim ☐	Këmbim ☒	Servitut ☐
-------------------------------------	--	-----------------------------------

III. PËRSHKRIMI I ZONËS PËRRETH, PRONËS SË PALUAJTSHME DHE TË DREJTAVE QË PREKEN NGA PROCESI I SHPRONËSIMIT

Karakteristike e përgjithshme e pozitës së Pejës është se; ajo shtrihet në skajin veri-perëndimorë të luginës së pëlleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske, nën shpatet e Alpeve shqiptare (Albanian Alps). Peja shtrihet në luginën e Lumëbardhit rrethuar me Alpet Shqiptare. Peja ngritët në fushën e rrafshit të Dukagjinit dhe rrenzë bjeshkëve të larta. Peja në pikëpamje gjeomorfologjike përbën një tërësi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja lidhet me qarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën.

Zona për të cilën po bëhet ky raport vlerësimi është lagje periferike e Qytetit të Pejës përkatesishtë zonë malore e quajtur Maja e Zezë. Zona Kadastrale Carraver shtrihet në vry të qytetit të Pejës, ka terren kryesisht kodrinor malor, përshkak të pozitës gjeografike, dhe afërsisht me qytetin e Pejës kjo zonë kohët e fundit është zhvilluar si zonë turistike, ku vërehen që janë ndërtuar objekte të shumta të tipit të villave.

Për vlerësimin e pronës së paluajtshme, stafi i Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim, filluan punën për inspektimin e pronës, përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për të dhënat e tregut në zonën përreth pronës, e cila është objekt vlerësimi.

Gjate inspektimit u kryen verifikimet për pronën që do të vlerësohet, u përcaktua vend ndodhja e pronës përmes elaboratit, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Vlerësimi i pronës është bërë në bazë të gjendjes faktike në ditën e inspektimit.

***Objekt vlerësimi në këtë raport është**

- Sipërfaqja e tokës e cila vlerësohet sipas elaboratit

Prona me numër 5502-3, e regjistruar me kulturë "Infrastrukturë/Krugë" në Zonën Kadastrale Pejë, ka një formë të rregullt drejtkëndore dhe një sipërfaqe të vogël. Ajo shtrihet në pjesën lindore të qytetit, pranë objektit të Elkos-it, në hyrje të qytetit dhe afër shtratit të Lumit Lumbardh. Sipas gjendjes në terren, prona objekt vlerësimi ndodhet në kufi me prona që përdoren për biznese, të ndryshme, por marr për bazë sipërfaqen nuk paraqet potencial si e vetme.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësimi, sipas elaboratit nuk ka "Pjesë aksesori" pjesët aksesore nënkuptojnë ndërtim, instalime, të cilat janë vendosur apo montuar në pronën e paluajtshme, për përdorim të përhershëm dhe të cilat nuk mund të shpëputen pa përpjekje të pa arsyeshme ose jo ekonomike.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësimi sipas elaboratit të shpronësimit, nuk ka "Fruta"- që nënkupton frutat e pa shpëputura nga toka, bimësinë vjetore apo të përhershme, në një pronë të paluajtshme.

Prona objekt i vlerësimit, vlerësohet bazuar në kërkesë referencë: 15-463/-LRL-74-2025 datë 04.03.2025-Komuna Pejë

SIPËRFAQJA:

Sipërfaqja sipas elaboratit:	272 m ²
Sipërfaqja që vlerësohet :	272 m ²
Prona u inspektua me datë :	30.04.2025

IV. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

Metodat e vlerësimit:

1	Metoda e kostos	
---	-----------------	--

2	Metoda e shitjeve krahasuese	✓
3	Metoda e të ardhurave	

